

VENDIM
Nr.57, datë 1.2.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË PJESE TË
GODINËS SË ISH-ISP-SË, NR.1, NË TIRANË, NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pjesës së ndërtesës së ish-ISP-së nr.1, në Tiranë, e cila aktualisht nuk shfrytëzohet, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, për Universitetin Politeknik të Tiranës, të përcaktuar në formularin përkatës të listës së inventarit, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Universitetit Politeknik të Tiranës i ndalohet ta ndryshojë destincionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve këtë pronë.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit Bashkia Tiranë Fusha e përdorimit të pronës: Zyrat e ish-Institutit të Studimeve e Projekttimeve ujësjellës-ndërtim							Identifikoi: Z.Mynyr Kuçi, specialist inxhinier Supervisor: Znj. Tana Kushova, Drejtore e Burimeve Njerëzore&Shërbimeve Aprovoi: Z.Arben Demeti, Zëvendësministër i MRRTT			
Nr. rendor	A			B			C			
Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale: sa e ndërtesës (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Godina e ISPUN	Rruga “Muhamet Gjollesha”	2360	2200	Zyrat e ISPUN	ISPUN	ISPUN	

